



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 1

Tiranë – E martë, 5 janar 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 1/2021, datë 4.1.2021	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme..... 3
Vendim i Kuvendit nr. 2/2021, datë 4.1.2021	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit të Mbrojtjes..... 3
Vendim i Kuvendit nr. 3/2021, datë 4.1.2021	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme..... 3
Vendim i Kuvendit nr. 4/2021, datë 4.1.2021	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Mbrojtjes..... 3
Dekret i Presidentit nr. 11883, datë 28.12.2020	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 4
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1098, datë 24.12.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Për ndërtimin e vendpërhejeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941”..... 4
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1101, datë 16.12.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave”, të ndryshuar..... 6
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1106, datë 24.12.2020	Për trajtimin financiar të mentorit në Shërbimin Informativ të Shtetit..... 6
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1112, datë 16.12.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në Bashkinë Shijak..... 7

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1113, datë 24.12.2020	Për masën dhe mënyrën e kompensimit të udhëtimit, të qirasë së banesës dhe rimbursimin e shpenzimeve të transferimit për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit.....	7
Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 357, datë 18.12.2020	Për disa ndryshime në urdhrin e përbashkët nr. 71, datë 25.2.2020, “Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2020–2021, në sistemin arsimor parauniversitar”	8

**VENDIM
Nr. 1/2021****PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR SHKARKIMIN E MINISTRIT PËR
EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të dekretit nr. 11 889, datë 31.12.2020, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 889, datë 31.12.2020, për shkarkimin e zotit Edi Rama nga detyra e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 4.1.2021

**VENDIM
Nr. 2/2021****PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR
SHKARKIMIN E MINISTRIT TË
MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të dekretit nr. 11 890, datë 31.12.2020, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 890, datë 31.12.2020, për shkarkimin e zonjës Olta Xhaçka nga detyra e ministrit të Mbrojtjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 4.1.2021

**VENDIM
Nr. 3/2021****PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR
EMËRIMIN E MINISTRIT PËR
EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të dekretit nr. 11 891, datë 31.12.2020, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 891, datë 31.12.2020, për emërimin e zonjës Olta Xhaçka në detyrën e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 4.1.2021

**VENDIM
Nr. 4/2021****PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR EMËRIMIN E MINISTRIT
TË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të dekretit nr. 11 892, datë 31.12.2020, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 892, datë 31.12.2020, për emërimin e zotit Niko Peleshi në detyrën e ministrit të Mbrojtjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 4.1.2021

**DEKRET**

Nr. 11883, datë 28.12.2020

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Ertugen Albert Mankollari
2. Rozafa Brahim Xhuxha (Lahi)
3. Deivi Juljan Xhuxha
4. Juljan Pjeter Xhuxha
5. Dario Juljan Xhuxha
6. Gerda Skënder Pistrick (Dalipaj)
7. Felix Fjodor Eckehard Pistrick
8. Gabriel Eckehard Pistrick
9. Albana Hasan Como (Kuçana/Kucana)
10. Erion Nijazi Mata
11. Besiona Bashkim Emiri
12. Alice Sophia Dhimitraq Jani
13. Thea Emily Dhimitraq Jani
14. Andi Fitim Behri
15. Irla Ilir Dautaj (Qordja)
16. Ajsela Meidin Ganteführer (Muka)
17. Alisa Ali Biba (Sakuta)
18. Viktor Lucë Gjinaj
19. Orkida Bajram Meraja
20. Baban Sagrous Meraja
21. Sazan Zagros Meraja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENTI REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 1098, datë 24.12.2020

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “PËR NDËRTIMIN E
VENDPREHJEVE TË USHTARAKËVE
GREKË, TË RËNË GJATË LUFTËS
GREKO-ITALIANE TË VITEVE
1940–1941”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10256, datë 25.3.2010, “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941 dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 742, datë 13.12.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr. 10256, datë 25.3.2010”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Për ndërtimin e vendprehjeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941”, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për



kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr. 10256, datë 25.3.2010.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Pronari i pasurisë të paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “truall”, me vlerë 733 700 (shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 733 700 (shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind) lekësh dhe shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të përballohen nga Ministria e Mbrojtjes.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

6. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur pranë Ministrisë së Mbrojtjes certifikatën e pronësisë, kartelën e

pasurisë së paluajtshme si dhe hartën treguese të regjistrimit.

7. Ministria e Mbrojtjes të kryejë procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

8. Afati i fillimit dhe mbarimit të punimeve të jetë në përputhje me parashikimet e projektit.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të shtetit.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit.

11. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

TABELA E SHPRONËSIMIT TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “PËR NDËRTIMIN E VENDPREHJEVE TË USHTARAKËVE GREKË, TË RËNË GJATË LUFTËS GREKO-ITALIANE TË VITEVE 1940–1941”

Nr.	Emër Mbiemër	Adresa	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall (m ²)	Sip. trualli i prekur (m ²)	Çmimi truall (lek/m ²)	Vlera (lek)	Sip. totale e ndërtesës me certifikatë (m ²)	Sip. e prekur e ndërtesës (m ²)	Vlera e ndërtesës me preventiv (lek)	Vlera e përgjithshme (lek)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Mitropolia e Shenjtë Gjrokastrë	Këlcyrë, Përmet	Truall	2131	362	7150	2900		733,700	61	-	-	733,700	Konfirmuar nga ZVASHK Përmet, më datë 23.10.2019.
Vlera paraprake e shpronësimit							2900	253	733,700		-	-	733,700	

**VENDIM****Nr. 1101, datë 16.12.2020**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, SI DHE ÇDO NDËRHYRJE TJETËR NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2.1, e vendimit nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.1 Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë 4 393 026 543 (katër miliardë e treqind e nëntëdhjetë e tre milionë e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, nga i cili:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 2 492 978 390 (dy miliardë e katërqind e nëntëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të

rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 1 900 048 153 (një miliard e nëntëqind milionë e dyzet e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe****VENDIM****Nr. 1106, datë 24.12.2020**

PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË MENTORIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005, “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Trajtimi financiar i mentorit në strukturat e linjës informative-operative në Shërbimin Informativ të Shtetit është në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.

2. Kur mentorin ka nën kujdes më shumë se 1 (një) punonjës në periudhë prove, trajtimi financiar mujor nuk e kalon masën totale mujore të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Mentorin nuk përfiton trajtim financiar në rast zgjatjeje të afatit të periudhës së provës për punonjësin që ka nën kujdes.



4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit.

5. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1112, datë 16.12.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË BANESAVE
INDIVIDUALE NË BASHKINË SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 240 505 492 (dyqind e dyzet milionë e pesëqind e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në Bashkinë Shijak.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020 dhe i transferohet Bashkisë Shijak në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1113, datë 24.12.2020

**PËR MASËN DHE MËNYRËN E
KOMPENSIMIT TË UDHËTIMIT, TË
QIRASË SË BANESËS DHE
RIMBURSIMIN E SHPENZIMEVE
TË TRANSFERIMIT PËR PUNONJËSIT
E SHËRBIMIT INFORMATIV
TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 3, e 22, pika 3, të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005, “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi që transferohet apo emërohet për herë të parë, jashtë vendbanimit, për nevoja dhe në interes të punës, përfiton pagesë për kompensim udhëtimi.

2. Masa e pagesës së kompensimit të udhëtimit është:

a) nga 36 km deri në 60 km, në masën	8 000 lekë/muaj;
b) nga 61 km deri 100 km, në masën	10 000 lekë/muaj;
c) nga 101 km deri 150 km, në masën	13 000 lekë/muaj;
ç) nga 151 km deri 200 km, në masën	15 000 lekë/muaj;
d) mbi 200 km, në masën	20 000 lekë/muaj.

3. Për përfitimin e pagesës për kompensim udhëtimi punonjësi paraqet në njësinë ku është transferuar apo emëruar për herë të parë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) kërkesën me shkrim, me gjenealitetet e plota, adresën e vendbanimit të tij/familjes, para transferimit apo emërimit, si dhe adresën ku banon përkohësisht vetë punonjësi dhe familja e tij;



b) fotokopjen e kartës së identitetit, si dhe të certifikatës familjare;

c) vërtetimin nga njësia administrative, për vendbanimin e familjes dhe të vetë punonjësit.

4. Punonjësi që transferohet apo emërohet për herë të parë, jashtë vendbanimit, për nevoja dhe në interes të punës, në një largësi mbi 36 km, kur ai ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi në vendin e punës, përfiton kompensim për qira banese dhe rimbursimin e plotë të shpenzimeve të transferimit të tij dhe/ose të familjes.

5. Punonjësi përfiton kompensim për qira banese, si më poshtë vijon:

a) banesë tipi 1 + 1, kur certifikata familjare e punonjësit përmban deri në dy pjesëtarë;

b) banesë tipi 2 + 1, kur certifikata familjare e punonjësit përmban më shumë se dy pjesëtarë.

6. Për përfitimin e pagesës së kompensimit për qira banese, punonjësi paraqet në njësinë ku është transferuar apo emëruar për herë të parë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) kërkesë me shkrim, me gjenealogjet e plotë;

b) fotokopje të kartës së identitetit dhe të certifikatës familjare;

c) kontratën e noterizuar të qirasë së banesës për një periudhë njëvjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje me të njëjtat kushte;

ç) vërtetim nga zyrtar/drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që ai ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi apo nuk ka aplikuar për legalizim banese në vendin ku është transferuar apo emëruar.

7. Dokumentacioni, sipas pikave 3 dhe 6 të këtij vendimi, përcillet te njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore.

8. Vlera e kompensimit të qirasë së banesës nuk do të jetë më e madhe se vlera e qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë, sipas vendimit të fundit të këshillit të njesisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.

9. Punonjësi përzgjedh njërin nga përfitimet, kompensim për qira banese ose kompensim udhëtimi.

10. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit miraton urdhrin për kompensimin e udhëtimit ose të qirasë së banesës.

11. Punonjësi përfitues njofton për çdo ndryshim të kushteve të përcaktuara në pikat 3 dhe 6 të këtij vendimi.

12. Përfitimi i pagesës për kompensim udhëtimi apo qira banese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit, që nënkupton sistemimin me banesë në juridiksionin e qendrës së punës, ku punonjësi është transferuar apo emëruar. Kjo pagesë do të përfitohet për një periudhë deri në tre vjet.

13. Punonjësit që aktualisht trajtohen me kompensim udhëtimi, përfitimet t'u rivlerësohen sipas afatit dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

14. Shpenzimet e transportit të pajisjeve, në rast të transferimit apo të emërimit për herë të parë të punonjësit, në masën deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, rimbursohen kundrejt faturës.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit.

16. Vendimi nr. 595, datë 5.9.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit, për shkak të natyrës së veçantë të punës dhe kufizimeve ligjore", shfuqizohet.

17. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR I PËRBASHKËT NR. 357, datë 18.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN E PËRBASHKËT NR. 71, DATË 25.2.2020, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2020–2021, NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",



URDHËROJMË:

1. Në urdhrin e përbashkët nr. 71, datë 25.2.2020, “Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2020–2021, në sistemin arsimor parauniversitar”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “b”, të pikës 1, të urdhrit, togfjalëshi “... më 4 janar 2021.” zëvendësohet me togfjalëshin “... më 11 janar 2021.”

b) Në shkronjën “c”, të pikës 2, të urdhrit, togfjalëshi “... më 4 janar 2021.” zëvendësohet me togfjalëshin “... më 11 janar 2021.”

c) Në shkronjën “d”, të pikës 3, të urdhrit, togfjalëshi “... më 4 janar 2021.” zëvendësohet me togfjalëshin “... më 11 janar 2021.”

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e

Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë